

Thirrje për aplikim

EdGuard në koordinim me Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (**AKK**) hap thirrje për aplikim në trajnimet certifikuese për:

1. Ekspert për vlerësim të jashtëm për akreditim të Institucioneve për zbatimin e të Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP-së);
2. Trajner të trajnerëve të praktikuesve të Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP);

Përshkrimi

Projekti “*European Union Support to Vocational Education and Training (VET), Professional Requalification and occupation (ESVET PRO)*” financohet nga **Bashkimi Evropian (BE)** dhe implementohet nga **Luxembourg Agency for Development and Cooperation (LuxDev)**. Fokusi parësor i projektit është përmirësimi i strukturës dhe performancës së sistemit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe ofrimit të AAP-së në Kosovë, si dhe promovimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor dhe mësimi gjatë gjithë jetës për të gjithë, në përputhje me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (SDG4).

Një nga objektivat kryesore të projektit është krijimi i parakushteve për ofrimin e Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP) në nivel vendi duke e bërë atë funksional në sektorët/ profesionet më të kërkuara ekonomike si një formë e rritjes së punësimit dhe mundësive të mësimi gjatë gjithë jetës për të rriturit.

Përgjatë projektit, mbështetje e konsiderueshme do t’u ofrohet institucioneve relevante me qëllim të krijimit dhe zbatimit të një sistemi efektiv të Njohjes së Mësimi Paraprak (NjMP). Komponentë e rëndësishme e kësaj mbështetje është ngritja e kapaciteteve të hisedarëve të përfshirë në proces. Si rrjedhojë, ndër të tjera projekti do të mbështesë AKK-në në procesin e (1) vlerësimit të institucioneve që zbatojnë NjMP-në; dhe (2) në ofrimin e trajnimeve për zbatuesit e NjMP-së (mentorë, koordinatorë, vlerësues të brendshëm dhe të jashtëm).

Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrje është rekrutimi i kandidatëve për përfitim nga programi i ngritjes së kapaciteteve për:

- **pesëmbëdhjetë (15) Ekspertë** të cilët do të angazhohen si pjesë e ekipeve vlerësuese për akreditim të Institucioneve zbatuese të NjMP-së,
- **pesëmbëdhjetë (15) Trajnerë** të cilët do të trajnojnë zbatuesit e NjMP-së (vlerësuesit, koordinatorët, mentorët) në të ardhmen.

Kriteret për aplikim

1. Ekspert për vlerësim të jashtëm për akreditim të Institucioneve për zbatimin e NjMP-së;

Për të qenë pjesë e programit certifikues “*Ekspert për vlerësim të jashtëm për akreditim të Institucioneve për zbatim të NjMP-së*”, individët e interesuar duhet të plotësojnë kriteret:

- 1.1. *Të kenë kualifikim profesional të profileve përkatëse;*
- 1.2. *Të kenë përvojë profesionale së paku dhjetë (10) vite në fusha përkatëse në të cilat pritet të zbatohet NjMP (si p.sh.: instalues elektrik, saldim, ndërtimtari, administrim biznesi, kontabilitet, parukeri, rrobaqepësi etj.);*
- 1.3. *Të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në arsim, menaxhim apo të ngjashme;*
- 1.4. *Të kenë njohuri për metodologji dhe për politikat për NjMP-në;*
- 1.5. *Të kenë njohuri për zhvillimet e kualifikimeve profesionale dhe të tregut të punës;*
- 1.6. *Të kenë njohuri të teknologjisë informative;*
- 1.7. *E dëshirueshme të kenë njohuri të gjuhës angleze.*

2. Trajner të trajnerëve të praktikuesve të NjMP-së

Për të qenë pjesë e programit certifikues “Trajner për praktikuesit e NjMP-së” individët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:

- 2.1. *Të kenë kualifikim profesional, së paku nivelin Bachelor të shkollimit universitar;*

- 2.2. Të kenë përvojë pune në ngritje të kapaciteteve dhe ofrim të trajnimeve (si trajner, instruktor) në fusha relevante;
- 2.3. Të kenë interes të shprehur për ngritje profesionale të kapaciteteve për ofrim të trajnimeve për zbatuesit e NjMP-së (vlerësuesit, koordinatorët, mentorët);
- 2.4. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi;
- 2.5. Të jetë i/e gatshëm/me për t'u angazhuar si trajner për zbatuesit e NjMP-së sipas nevojave të AKK-së pas certifikimit;

Si të aplikohet?

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të dërgojnë (1) CV-në dhe (2) një letër motivuese në email adresën shoxha@edguard.org, dhe duke mbajtur ne kopje (CC) info.akk@rks-gov.net, jo më vonë se **15/05/2022** në ora **17:00**.

Për çfarëdo pyetje apo informate shtesë rreth thirrjes dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni përmes email adresës shoxha@edguard.org ose në numrin e telefonit (+383) 38 77 88 90.

Ky aktivitet është pjesë e projektit *European Union Support to Vocational Education and Training (VET), Professional Requalification and occupation (ESVET PRO)*, i zbatuar nga **LuxDev** dhe përkrahur nga **Bashkimi Evropian**.

Procedurat e përzgjedhjes

Aplikacionet e marra nga kandidatëve do t'i nënshtrohen procedurës së hollësishme të vlerësimit. Një grup vlerësues i përbërë nga përfaqësues të projektit bashkë me përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), do të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve varësisht nga përmbushja e kriterëve të paracaktuara përmes thirrjes. Kandidatët të cilët kanë përmbushur kriteret do të informohen me kohë mbi përzgjedhjen dhe hapat e mëtejme.